



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 06
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 1 dhjetor 2017, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Munguan: Faton Topalli, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, Flora Brovina dhe Bekim Haxhiu.

Pjesëmarrës të tjerë: Ervin Ibrahim – UNDP.

Stafi mbështetës i komisionit: Shprese Haxhijaj, koordinatore e komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 8.11.2017 dhe 14.11.2017;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndërmarrjet sociale;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 8.11.2017 dhe 14.11.2017

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale miratoi, pa vërejtje, procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 8.11.2017 dhe 14.11.2017

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndërmarrjet sociale

Kryetarja: Kalojmë te shqyrtimi dhe miratimi në parim i Projektligjit për ndërmarrjet sociale, atëherë të gjithë ju e keni shqyrtuar këtë Projektligj, të cilin e kemi shqyrtuar edhe në legjislaturën e kaluar, të cilin e kemi kaluar vetëm në parim edhe është shpërndarë Kuvendi. Me sa kam vërejtur tani drafti i ri ka vetëm ndryshim të çështja e gjobave, ku janë harmonizuar me ligjin për kundërvajtje. Unë kam pasur vërejtjet e mia, mirëpo jam që të miratojmë në parim Projektligjin dhe gjitha vërejtjet do t'i shqyrtojmë gjatë shqyrtimit apo fazës së amendamentimit. Atëherë të gjithë ju e keni shqyrtuar këtë projektligj dhe nëse dikush ka ndonjë vërejtje apo koment?

Time Kadrijaj: Ne sot të miratojmë në parim Projektligjin dhe gjatë leximit të dytë do të shqyrtojmë dhe nëse ka nevojë do të amendantojmë. Pas kalimit në seancë do të themelojmë grupin punues dhe atëherë do të kemi mundësi të plotësojmë.

Naser Rugova: Edhe unë jam që të miratojmë në parim Projektligjin dhe mandej grupi punues duhet të shqyrtojë me kujdes dha gjatë shqyrtimit t'i ftojme përfaqësuesit e qeverisë, si dhe të gjithë palët që interferojnë në këtë projektligj me qëllim që të miratojmë një ligj i cili do të jetë sa me i mirë dhe i zbatueshëm në praktikë. Po ashtu edhe dëgjimin publik duhet të organizojmë dhe t'i marrim gjitha imputet e nevojshme.

Kryetarja: Pajtohem me ju që duhet të organizojmë dëgjim publik dhe do t'i ftojme të gjitha palët që konsiderojmë se mund të japin kontributin e tyre që të kemi një ligj sa më të mirë e të zbatueshëm. Me lejoni edhe t'ju njoftoj se unë kam realizuar një takim me përfaqësuesin e UNDP-së në Kuvend. Pas takimit që kemi pasur me drejtorin e UNDP-së në Kosovë, kemi kërkuar që të na mbështet që të marrim përvoja nga ndonjë vend i cili do të na ndihmojë në këtë projektligj, pasi që është një koncept i ri edhe në vendet e rajonit. UNDP ka shprehur gatishmëri të na mbështet me një vizitë studimore që të shohim nga afër praktikat e funksionimit të ndërmarrjeve sociale.

Haxhi Avdyli: Ky është një ligj i rëndësishëm dhe duhet të miratohet, por kam dilema rreth mundësisë së keqpërdorimit të ligjit duke krijuar ndërmarrje fiktive, prandaj duhet krijuar organizma kontrollues që mos të vijë deri te keqpërdorimet. Vetë fakti që në Kosova ka me mijëra OJQ fiktive shton dyshimet që mos po ndodh njëjtë edhe me ndërmarrjet sociale. T'i kushtojmë rëndësi edhe të krijojmë mekanizma ligjor që t'i evitojmë keqpërdorimet.

Enver Hoti: Pajtohem që Projektligji të kalojë në parim dhe të shkojë në Kuvend për miratim. Mendoj se ky ligj është i domosdoshëm për t'i ndihmuar kategoritë me nevoja të veçanta, por edhe duke pasur parasysh papunësinë e madhe që është në Kosovë. Mendoj që Ligji është i qartë dhe i parandalon të gjitha mundësit e keqpërdorimit. Mendoj që Projektligji duhet të miratohet sa më shpejt.

Time Kadrijaj: Pasi Projektligji të kalojë në parim ne duhet të organizojmë edhe dëgjim publik në mënyrë që ta amendantojmë dhe ta bëjmë një ligj sa më të mirë. Gjithashtu, si komision,

kemi mundësi që ligjet t'i monitorojmë a po zbatohen dhe të japim rekomandime për qeverinë se në cilat nene ligji konkret i cili monitorohet, nuk po zbatohet.

Kryetarja: Lidhur me këtë Projektligj kemi negociuar edhe me UNDP –në që të këmbejmë përvoja edhe me ndonjë shtet të rajonit. Pas miratimit në parim të projektligjit do ta formojmë edhe grupin punues.

Pas diskutimeve, Komisioni me shumicë votash miratoi në parim Projektligjin për ndërmarrjet sociale, dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-022 për ndërmarrjet sociale.

4. Të ndryshme

Kryetarja: Në këtë pikë kemi disa kërkesa, një nga to është edhe kërkesa e Klinikës së Reumatologjisë, ku shprehet shqetësimi për vendimin e zhvendosjes së kësaj klinike në një repart tjetër. Ne, si komision, nuk kemi shumë kompetenca në këtë çështje, por ndoshta mund ta bëjmë një vizitë në SHSKUK, e të dëgjojmë për problemet me të cilat ballafaqohet sot, por edhe të bisedojmë me ud. drejtorin për problemin e funksionalizimit të kardiokirurgjisë. Gjithashtu mund t'i vizitojmë edhe disa klinika, ndër to edhe Klinikën e Reumatologjisë.

Haxhi Avdyli: Pajtohem ta realizojmë një vizitë në SHSKUK, sepse ka shumë probleme me të cilat ballafaqohet sot. Kardiologjia është një repart shumë i rëndësishëm dhe i cili po ballafaqohet me shumë probleme. Mendoj që ka edhe shumë klinika të tjera, të cilat kanë probleme të hapësirave, si Klinika e Neurokirurgjisë e cila nuk ka hapësira të mjaftueshme. QKUK funksionon sikur para 30 viteve pa i shikuar nevojat për hapësira dhe pa i shikuar nevojat për ndryshime. Disa sëmundje janë duke u zvogëluar, si sëmundjet infektive, ndërsa disa po rriten si sëmundjet kanceroze dhe ato kardiovaskulare, por që nuk po përcjellën me hapësira të mjaftueshme. Këto hapësira duhet të ri dizajnohen sipas shfrytëzueshmërisë së shtretërve.

Time Kadrijaj: Mendoj që ne duhet të shkojmë në SHSKUK dhe të njoftohemi me situatën. Të angazhohemi të gjithë të gjejmë një kompromis që të gjithë të ndahen të kënaqur me hapësirat që i shfrytëzojnë. Gjithashtu mendoj që neurokirurgjisë duhet t'i zgjerohen hapësirat sepse është shumë pak për këtë repart të rëndësishëm vetëm një sallë operative.

Naser Rugova: Mendoj se duhet të organizohet një debat publik me statistika të sakta për shfrytëzueshmërinë e hapësirave publike dhe shtretërve në QKUK. Ka statistika jo zyrtare që rreth 40% të hapësirave në QKUK nuk shfrytëzohen dhe që zhvendosja e një klinike prej një hapësire në tjetrën, po merr kohë dhe pacientët po dëmtohen. Kardiologjia invazive dhe kardiokirurgjia duhet të jenë nën një kulm për shkak të lidhjes profesionale. Unë mendoj që nuk është menaxhuar mirë shpërndarja e hapësirave. Gjithashtu mendoj që drejtori i SHSKUK duhet të zgjidhet sa më parë, e jo të zgjat me vite me ushtrues detyre, se kjo po i dëmton institucionet.

Enver Hoti: Çështja e hapësirave mendoj se është çështje e menaxhmentit të SHSKUK- ut, por është shqetësuese nëse janë të sakta statistikat që 40% e hapësirave nuk shfrytëzohen. Mendoj se duhet të ftohet në mbledhje të komisionit ministri i Shëndetësisë dhe të na njoftojë për gjendjen

në objektet e QKUK si funksionojnë. Prapë mendoj që ne nuk duhet të përfshihemi në menaxhimin e QKUK, konfigurimi i hapësirave duhet të bëhet sipas nevojave të tyre.

Besa Baftiu: Vizita jonë në SHSKUK, nuk do jetë me qëllim të ndërhyrjes, por vetëm njoftim me gjendjen. Përveç hapësirave mendoj që edhe distribuimi i kuadrove në SHSKUK nuk është sipas nevojave të klinikave dhe spitaleve.

Haxhi Avdyli: Kohëzgjatja e qëndrimit të pacientëve në spital është shkurtuar dhe po shkojmë ka ajo që të shkurtohet edhe më shumë. Unë po e ngriti çështjen edhe për hapësirat e jashtme të QKUK-së, se kush po i shfrytëzon ato hapësira, qoftë për biznese apo për veprimtari të tjera.

Besa Baftiu: Kjo është një çështje e rëndësishme dhe donë trajtim, por pasi SHSKUK udhëhiqet me ud. Drejtor, ndoshta këtë problem duhet ta diskutojmë me bordin apo pasi të zgjidhet drejtori.

Pas diskutimeve komisioni vendosi ta takojë drejtorin e SHSKUK-ut, dhe t'i vizitojë edhe Klinikën e Reumatologjisë dhe Neurokirurgjisë.

Besa Baftiu: Në këtë pikë kemi edhe një shkresë të Odes së Farmacistëve për procedimin e një ligji të ri për produktet farmaceutike. Mendoj se Ministria e Shëndetësisë është më kompetente se komisioni të japë një mendim rreth nevojës për këtë Projektligj. Besoj se kjo kërkesë do të shqyrtohet edhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe do ta marrë një përgjigje.

Gjithashtu në këtë pikë kemi edhe një kërkesë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për nominimin e një anëtari për Komitetin Mbikëqyrës për Hulumtimin, Vlerësimin e shërbimeve esenciale të shëndetësisë publike në Kosovë përmes instrumentit vlerësues të OBSH. Pra, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, së bashku me Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSH) do të bëjnë vlerësimin e shërbimeve esenciale të shëndetësisë publike në Kosovë duke shfrytëzuar instrumentin vlerësues të OBSH- së për Rajonin Evropian “Self-assessment tool for the evaluation of essential public health operations in the WHO European Region” me qëllim të definimit të shëndetësisë publike moderne.

Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës propozoi që të nominojë Muhamet Bytyçin, zyrtar i komisionit që të jetë anëtar në Komitetin Mbikëqyrës për Hulumtimin dhe Vlerësimin e shërbimeve esenciale të shëndetësisë publike në Kosovë.

Ju faleminderit për pjesëmarrje!

Mbledhja përfundoi në orën 10:55.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU